



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:214537

Datë: 12.01.2024

Numri i dokumentit: 05181578

C.nr.597/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh. B. nr. personal, nga fshati H., Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Xh. B., avokat nga Prishtina, U. A., H., nr..., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, Rruga “L. e Pejës”, pn., të cilën e përfaqëson i autorizuari Kompania e Sigurimeve “I.” Sheshi “N.T.” nr..., me autorizim, me objekt kontesti Kompensim dëmi, me vlerë të kontestit: 4,000.00 Euro, jashtë seance me dt.12.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Xh. B. nga fshati H., Komuna e Podujevës, me të cilën ka kërkuar që të:

“Detyrohet Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, në Prishtinë, që t’i kompensoi paditësit Xh. B. për dëmin material dhe jo material dhe atë: për dhimbjet fizike, frikës, zvogëlimit të aktivitetit jetësorë, shëmtimit, ndihmës së huaj, ushqimit të përforcuar, terapisë fizikale dëmtimit të gardërobës etj.

Kompensimi i dëmit do të bëhet ne atë lartësia, që do të ndryshohet vetëm pas dhënies së mendimit nga eksperti i mjekësisë të gjitha këto me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë.

Detyrohet e paditura, gjithashtu Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, bazuar në Tarifën e Avokatëve (neni 5 i tarifës së Avokatëve për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve).”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditës, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri që në emër të kompesimit të dëmit, paditësit t'ia paguajë dëmin i cili do të ndrushohet pas dhënies së mendimt nga ekspertët e mjekësisë, kamatën nga dita e ngritjes së padisë, si dhe shpenzimet e procedurës. Ka shtuar se i padituri me datën 05.08.2019, është shkaktuar aksident trafiku ku lëndime trupore ka pësuar paditësi. Aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia e ngasësit të automjetit A, të përshkruar në raportin e policisë, duke mos pasur kujdes në trafik ka shkaktuar aksident trafiku ku i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore – dëm jo material dhe material.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, të provuarit e fakteve, mjeteve provuese, ta aprovojë si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi, ka theksuar se lidhur me dëmin material dhe jo material, të cilin paditësi e ka pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 05.08.2019 është parashtruar kërkesë për kompensim dëmi në procedurë jashtëgjyqësore, për çka edhe kanë arritur pajtim jashtëgjyqësor dhe është paguar me datën 19.06.2020. për këtë si provë ka bashkangjitur Pajtimin jashtëgjyqësor të datës 17.06.2020 dhe Transferin bankar të datës 19.06.2020. Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje konform dispozitave të nenit 152 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), vendosi që të bie aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, meqë i padituri i ka pohuar faktet vendimtare sipas parashtrësës mbi pagesën e shumës në emër të rimbursimit të dëmit të kërkuar nga paditësja, e që kjo dispozitë ligjore përcakton se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji)”*, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij. Gjykata bazuar në dispozitat e cituara dhe provave të ofruara nga palët ndërgjyqësore, ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Andaj, gjykata konform nenit 152 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-007 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), përkatësisht nenit 8 par.1 ku është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*, si dhe dispozitës së nenit 245 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, ku është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.”*, ndërsa dispozita e nenit 276 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *“Detyrimi shuhet kur ai përmbushet si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj.”*

Prandaj, në rastin konkret gjykata vendosi që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, meqë palët ndërgjyqësore çështjen e ngritur me padi e kanë zgjidhur me pajtimin jashtëgjyqësor të datës 17.06.2020, dhe se pala e paditur e ka përmbushur në tërësi obligimin sipas këtij pajtimi

jashtëgjyqësor në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 05.08.2019, e që dëshmohet sipas transaksionit bankar Transferit nga kontoja i BKS në Banka Ekonomike nr. FK-.../2019 të dt.19.06.2020, mbi pagesën e mjeteve bazuar në pajtimin jashtëgjyqësore, në shumë të përgjithshme prej 3,615.00€, në llogarinë e të autorizuarit të paditësit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 449 dhe 450 të LPK-së, ashtu që gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e cekura me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.597/2019, me datën 12.01.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.